



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
DREJTORIA E MIGRACIONIT, DIASPORES DHE E ÇESHTJEVE SOCIALE
SEKTORI I ÇESHTJEVE SOCIALE

Projekt-Vendim Nr 42 Datë 18.12.2025

Nr. 372 Prot

Fushë-Arrëz, me 18 / 12 /2025

**“ MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR
BLLOK-NDIHMËN MBI FONDIN 6% , NËNTOR 2025”**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, të nenit 7, të ligjit nr. 57/2019, datë 18.07.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të Kreut IV, pika 2 të Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të ndihmës ekonomike”, të ndryshuar, dhe Vendimit nr. 5, datë 23.02.2018, “Mbi miratimin e kriterëve për familjet në nevojë”, me përjashtim të pikave 1, 6 dhe 7 që do të trajtohen me ndihmën ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike, si dhe VKB Nr.2, datë 27.01.2025 “Për miratimin e kriterëve të përfitimit të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% për vitin 2025”, Sektori i Çeshtjeve Sociale, i propozon Këshillit të Bashkisë Fushë-Arrëz P/Vendimin për familjet aplikuese, që nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit, të cilët do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar 6% për Bllok Ndhmën, pas verifikimit nga administratorët social të cdo njësie administrative për muajin **NËNTOR 2025:**

Të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **NËNTOR 2025**, 26 familje, me fond **104,758** lekë nga fondi total i ndihmës ekonomike në vlerën **1,745,977** lekë dhe shpërndarë për përfituesit e 6% në Shumën **104,376** lekë sipas Njësive:

1. **Bashkia Qendër Fushë-Arrëz , 13 familje me fond 41,828 lekë.**
2. **Njësia Administrative Qafë-Mali, 3 familje me fond 11,821 lekë .**
3. **Njësia Administrative Blerim, 3 familje me fond 14,313 lekë.**
4. **Njësia Administrative Fierzë, 3 familje me fond 19,424 lekë .**
5. **Njësia Administrative Iballë, 4 familje me fond 16,990 lekë .**

Përgjegjëse e Çeshtjeve Sociale

Klotilda Curri



K R Y E T A R I

Hil CURRI

Juriste

Redona Hasani





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
DREJTORIA E MIGRACIONIT, DIASPORES DHE E ÇESHTJEVE SOCIALE
SEKTORI I ÇESHTJEVE SOCIALE

Nr. 382 Prot

Fushë-Arrëz, më 18/12/2025

**“ MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR
BLLOK-NDIHMËN MBI FONDIN 6% , NËNTOR 2025”**

RELACION

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, të nenit 7, të ligjit nr. 57/2019, datë 18.07.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të Kreut IV, pika 2 të Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të ndihmës ekonomike”, të ndryshuar, dhe Vendimit nr. 5, datë 23.02.2018, “Mbi miratimin e kriterëve për familjet në nevojë”, me përjashtim të pikave 1, 6 dhe 7 që do të trajtohen me ndihmën ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike. si dhe VKB Nr.2, datë 27.01.2025 “Për miratimin e kriterëve të përfitimit të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% për vitin 2025”, Sektori i Çeshtjeve Sociale, i propozon Këshillit të Bashkisë Fushë-Arrëz P/Vendimin për familjet aplikuese, që nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit, të cilët do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar 6% për Bllok Ndihmën, pas verifikimit nga administratorët social të cdo njësie administrative për muajin **NËNTOR 2025**.

Në Bashkinë Fushë-Arrëz, trajtohen me Ndihme Ekonomike, mbi fondin e kushtëzuar për bllok-ndihmen ekonomike në masen 6%, familje të cilat janë në kushte shumë të vështira ekonomike, ku bazohemi edhe në kriteret sipas marrjes së vendimit të VKB. Qëllimi i trajtimit të këtyre familjeve me bllok-ndihmë 6% , është të ofrohet ndihmë për grupet në nevojë, të cilët nuk sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, si dhe zbutje të varfërisë.

Trajtohen me ndihmën ekonomike 6% :

Të gjitha familjet që dalin nga sistemi për pikë të pamjaftueshme:

1. Drande Bardhok Gjonaj
2. Liza Ndue Cenaj
3. Ndoc Kol Prendi
4. Shkurte Cub Marinaj

-Largohet nga bllok-ndihma prej 6% familja:

1. Zef Mejdani (Njësia Administrative Qafë-Mali).

-Të shtohen në bllok-ndihmën e 6% familjet:

1. Shkurte Cub Marinaj (Bashkia Qendër Fushë-Arrëz).

Përgjegjëse e Çeshtjeve Sociale

Klotilda Curri



Juriste

Redona Hasani



K R Y E T A R I

Hil CURRI

